

Në bazë të nenit 55 paragrafi 1 të Ligjit për organizim dhe punë të organeve të administratës shtetërore (“Gazeta zyrtare e RM” nr.58/00 dhe 44/02) dhe neni 24 dhe 26 të ligjit për arsim të mesëm (“Gazeta zyrtare e RM” nr.44/95, 24/96, 34/96, 35/97, 82/99, 29/02, 40/03, 42/03, 63/04, 82/04, 55/05, 81/05, 113/05, 35/ 06, 70/06 dhe 51/07), ministri i arsimit dhe shkencës miratoi program mësimor në lëndën fakultative projekte nga arti muzikor për klasën e VI të arsimit fillor tetëvjeçar, përkatësisht për klasën e VII, VIII ose IX për arsimin fillor nëntëvjeçar.

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
ENTI PËR ZHVILLIMIN E ARSIMIT

PROGRAMI MËSIMOR

PROJEKTE NGA ARTI MUZIKOR

LËNDË FAKULTATIVE

ARSIMI FILLOR

1. HYRJE

Lënda mësimore *projekte nga arti muzikor* është lëndë fakultative që nxënësit mund ta zgjedhin arsimit fillor nëntëvjeçar (në klasën të VII, të VIII ose të IX). Fondi javor i orëve të kësaj lënde është 2 orën në javë, përkatësisht 72 orë gjatë gjithë vitit shkollor.

Projekte e ofruara nga arti muzikor kanë për synim t'i thellojnë njohuritë dhe aftësitë e nxënësve të përvetësuar gjatë programit mësimor të rregull të lëndës të muzikës, kurse nga ana tjetër të mundësojnë realizimin e interesave dhe afiniteteve individuale dhe aftësive muzikore të nxënësve.

Programi mësimor projektues e nxit pavarësinë e nxënësve, kreativitetin tyre, sensin për punë dhe hulumtim ekipor, aftësinë të prezantohet dhe ta vlerësoj aktivitetin e vet dhe atë të tjerëve. Përmbajtjet dhe aktivitetet e ofruara japin mundësi për ndikim pozitiv mbi personalitetin e nxënësve në këtë periudhë të zhvillimit.

Në këtë lëndë mësimore, si dhe tek lëndët e tjera, theksohet lidhshmëria e mësimimit me përvojën e nxënësve, organizimi fleksibil i orëve, nxitja e aktiviteteve individuale dhe punës në grup e nxënësve duke mundësuar në këtë mënyrë plotësim më të mirë me lëndët e tjera dhe bashkëpunim në procesin e mësimdhënies dhe të përvetësimit.

SHËNIM:

Në pajtim me dinamikën për futjen e edukimit dhe arsimimit fillor nëntëvjeçar programi mësimor për nxënësit e klasës të VI të arsimit fillor tetëvjeçar të vitit shkollor 2008/09 është ekuivalent me programin mësimor për klasën e VII, të VIII ose të IX të arsimit fillor nëntëvjeçar.

2. SYNIMET TË PROGRAMIT MËSIMOR PËR KLASËN E VII, VIII OSE TË IX

Nxënësi/ nxënësj:

- Të përvetësoj njohuri për strukturën e projektit nga fusha e artit muzikor (planifikimin i aktiviteteve dhe të kuadrit kohor, role, faza në realizimin, prezantimin dhe vlerësimin e rezultatit),
- të zhvilloj kreativitetin e vet;
- ta forcoj vetëbesimin nëpërmjet angazhimit personal dhe prezantimit të produktit të vet;
- t'i shtoj njohuritë për jetën dhe krijimtarinë e kompozitorëve të njohur;
- t'i thelloj njohuritë për këngët dhe ritet popullore të lidhura me festat;
- t'i shtoj njohuritë për stile të ndryshme të muzikës vokale dhe instrumentale;
- të interpretoj këngë nga stile të ndryshme;
- të interpretoj muzikë instrumentale nga stile të ndryshme;
- të njihet me mundësitë që ofron kompjuteri multimedial në lëndën e muzikës;
- të aplikoj programe muzikore speciale;
- të aftësohet për prezantim publik dhe ose për shfaqje skenike.

3. SYNIME KONKRETE

<i>Projekt nga arti muzikor</i>			
Synime	Përmbajtje	Terma	Aktivitete dhe metoda
<p>Nxënësi/nxënësja:</p> <p>-të aftësohet ta zbatoj metodologjinë për hartimin e një projekti nga arti muzikor</p>		<p>-Projekt -Ekip -Kordinator -Hulumtim -Vetëvlerësim</p>	<p>1. Zgjedhja e temës (përmbajtja) për projekt; -formimi i ekipit; -ndarja në grupe dhe caktimi i kordinatorëve të grupeve. 2. Plani veprues; -vendosja e një synimi të caktuar; -përcaktimi i kuadrit kohor; -planifikimi i aktiviteteve brenda atij kuadri. 3. Realizimi i planit; -mbledhja e materialit; -shkëmbim informacionesh brenda intervaleve të rregullta kohore; -analiza dhe sistemimi i të dhënave 4. Prezantimi i aktivitetit projektues (gojor duke përdorur TIK, shkrim, koncert etj.). 5. Vetëvlerësim i projektit (diskutim i pjesëmarrësve për përvojat në realizimin e projektit).</p>

Projekt: gazetarë muzikor			
Synime	Përmbajtje	Terma	Aktivitete dhe metoda
<p>Nxënësi/nxënësja:</p> <p>- t'i shtoj njohuritë për jetën dhe krijimtarinë e kompozitorëve të njohur</p>	<p>-Portrete kompozitorësh (për shembull: Vivaldi, Moxart, Betoven, Çajkovski, Prokopiev, Shuplevski, jakova, Domi etj. sipas dëshirës të nxënësit)</p>	<p>Në lidhje me projektin</p>	<p>Shembull:</p> <p>Projekt: <i>Jeta dhe vepra e një kompozitori të caktuar.</i></p> <p>Qëllimi i projektit: të studiohet jeta dhe vepra e kompozitorit të dhënë.</p> <p>Aktivitete: vizita në institucione muzikore, takime me muzikantë të njohur, kërkime në bibliotekë dhe në Internet, dëgjim i veprave të autorit</p> <p>Realizimi sipas metodologjisë për hartim dhe realizim të projektit.</p> <p>.</p> <p>.</p>

Projekt: Folklori muzikor rreth nesh			
Synime	Përmbajtje	Terma	Aktivitete dhe metoda
<p>Nxënësi/nxënësja:</p> <p>-t'i thelloj njohuritë për këngët dhe ritet popullore të lidhura me festat (sipas dëshirës të nxënësve)</p>	<p>-Folklori muzikor (këngë dhe rite popullore të lidhura me festat – Krishtlindjet, Pashkët, Bajramin etj.)</p>	<p>Në lidhje me projektin</p>	<p>Shembull:</p> <p>Projekt: <i>Këngë dhe rite lidhur me festën karakteristike për mjedisin.</i></p> <p>Qëllimi i projektit: të studiohet riti dhe këngët karakteristike për festën.</p> <p>Aktivitete: vizita në institucione muzikore, takime me muzikantë të njohur, kërkime në terren, bibliotekë dhe në Internet, dëgjim muzike.</p> <p>Realizimi sipas metodologjisë për hartim dhe realizim të projektit.</p>

Projekt: Grup këngëtarësh			
Synime	Përmbajtje	Terma	Aktivitete dhe metoda
<p>Nxënësi/nxënësja:</p> <p>- t'i shtoj njohuritë për stile të ndryshme të muzikës vokale;</p> <p>-të interpretoj këngë nga stile të ndryshme</p>	<p>Interpretim këngësh nga stile të ndryshme (pop, rok, folklor tradicional etj)</p>	<p>- Në lidhje me projektin</p>	<p>-Shembull: Projekt: <i>Stil i caktuar muzikor</i>. Qëllimi i projektit: të përgatiten një numër i caktuar këngësh për shfaqje skenike. -formimi i ekipit projektues dhe ndarja në grupe (këngëtarë, organizator të shfaqjes skenike, disenjator të materialit reklamues, kërkues etj.). Aktivitete: vizita në institucione muzikore, takime me muzikantë të njohur, kërkime në bibliotekë dhe në Internet, dëgjim muzike, përgatitja e materialit, bërja e provave . Realizimi sipas metodologjisë për hartim dhe realizim të projektit.</p>

Projekt: Grup instrumental			
Synime	Përmbajtje	Terma	Aktivitete dhe metoda
<p>Nxënësi/nxënësja:</p> <p>- t'i shtoj njohuritë për stile të ndryshme të muzikës instrumentale;</p> <p>-të interpretoj muzikë nga stile të ndryshme</p>	<p>Interpretim muzike nga stile të ndryshme (pop, rok, folklor tradicional etj)</p>	<p>-Grup instrumental</p> <p>-Bend</p> <p>-Orkestër</p> <p>-Ansambël</p> <p>Terma të tjerë në lidhje me projektin</p>	<p>-Shembull: Projekt: <i>Stil i caktuar muzikor</i>.</p> <p>Qëllimi i projektit: të përgatiten një numër i caktuar kompozimesh për shfaqje skenike.</p> <p>-formimi i ekipit projektues dhe ndarja në grupe (instrumentist, organizator të shfaqjes skenike, disenjator të materialit reklamues, kërkues etj.).</p> <p>Aktivitete: vizita në institucione muzikore, takime me muzikantë të njohur, kërkime në bibliotekë dhe në Internet, dëgjim muzike, përgatitja e materialit, bërja e provave.</p> <p>Realizimi sipas metodologjisë për hartim dhe realizim të projektit.</p>

Projekt: Muzikë dhe kompjuter			
Synime	Përmbajtje	Terma	Aktivitete dhe metoda
<p>Nxënësi/nxënësja:</p> <p>-Të njihet me mundësitë që i ofron kompjuteri multimedial në lëndën e muzikës.</p> <p>-të njihet me MIDI sistemin;</p> <p>-të njihet me MIDI kontrolluesit;</p> <p>-të aftësohet të përdor programe speciale muzikore; editorë muzikor, aplikime multimediale ose programe zbavitëse;</p> <p>-</p>	<p>-Njohja me kompjuteri multimedial standard (karta zanore dhe CD-pajisja)</p> <p>- MIDI sistem</p> <p>- MIDI kontrollues</p> <p>Softuer mësimor:</p> <p>PROGRAME TË HAPURA</p> <p>-editor muzikor</p> <p>-sekuencor</p> <p>-editor zanor</p> <p>-platforma multimediale</p>	<p>-Kompjuter multimedial</p> <p>-Kartë zanore</p> <p>-CD-pajisje</p> <p>-Organo</p> <p>-USB/MIDI klaviatura</p> <p>- MIDI sistem</p> <p>- MIDI kontrollues</p> <p>-Program i hapur (nxënësi mund të ketë qasje tek ndonjë informacion i caktuar, ta ndryshoj dhe ta përshtat sipas nevojave të veta)</p>	<p>-Njohja me kompjuterin multimedial standard (karta zanore dhe CD-pajisja);</p> <p>-Interpretimi në organo sipas ushtrimeve melodike të caktuara.</p> <p>-Njohja me MIDI sistemin (Interfejs dixhital për instrumente muzikore – mundëson të ruhen, incizohen sekuenca, të riprodhohen në organo).</p> <p>-njohja me MIDI kontrolluesit (kontrollues është pajisje mekanike që i imiton instrumentet muzikore tradicionale, e transformon interpretimin muzikor në MIDI informacion).</p> <p>-ushtrime: aplikimi i editorëve muzikor (programe shkrimi, rregullimi dhe printimi të partiturave)</p> <p>-ushtrime: aplikimi i sekuencorëve (programe për incizimin, modifikimin dhe riprodhimin e sekuencave gjatë shfaqjeve muzikore).</p> <p>-ushtrime: editorë zanor (programe që mundësojnë pasjen dhe ndryshimin e parametrave që janë pjesë e sintetizimit të tingullit).</p> <p>-ushtrime: aplikimi i platformave multimediale (programe të pastrukturuara që mundësojnë që krijimin e ushtrimeve të ndryshme)</p>

4. REKOMANDIME DIDAKTIKE

Lënda mësimore fakultative *projekte nga arti muzikor* jep mundësi integrimi me përmbajtjet e programit të edukim artistik, si dhe me përmbajtjet e lëndëve të tjera mësimore. Gjithashtu, ka mundësi për integrim të brendshëm në përmbajtjet e aktiviteteve të projektuara. Mësuesi duhet t'i ndihmoj nxënësit që t'i përvetësojnë fazat dhe hapat në hartimin e projektit (zgjedhja e temës, përcaktimi i qëllimit, formimi i ekipit, ndarja e roleve, planifikimi i aktiviteteve, përcaktimi i kuadrit kohor). Në program ofrohen disa lloje projektesh nga fusha të ndryshme (këngë, interpretim në instrumente, dëgjim muzike, folklor muzikor, TIK në muzikë). Sipas modele të gatshëm mësuesi mund të bëj projekte të veta dhe tua ofroj ato nxënësve. Zgjedhja e projekteve dhe caktimi i numrit të tyre për një vit shkollor bëhet sipas vlerësimit të mundësive dhe afiniteteve të nxënësve (p.sh. nëpërmjet anketimit të nxënësve). Kohëzgjatja e një projekti caktohet nga mësuesi, sipas llojit të projektit (nga një semestër tremujor deri në një vit shkollor). Për përpilimin e kuadrit kohor të një projekti mësuesi duhet të caktoj disa orë për prezantimin përfundimtar (ushtrimi i prezantimi gojor dhe përdorimi i veglave të nevojshme – reklamë, Power Point etj. ose prova, provë e përgjithshme me veshje konceptore, përgatitje psikologjike, ushtrim i sjelljes në skenë etj.).

- *Mjete mësimore:*
- udhëzues për mësuesin;
- mjete audio-vizuale (TV, DVD-pleer, videopleer, kompjuter, organo etj.);
- mjete dhe materiale didaktike
- burime të ndryshme mësimi në mjedisit përreth (biblioteka, instrumente muzikore etj.);
- mjete vizuale (piktura, fotografi, aplikime etj.)
- Internet, softuerë muzikor ;

5 MËNYRA E NDJEKJES DHE E VLERËSIMIT TË ARRITJEVE TË NXËNËSVE

Gjatë mësimit ndiqen dhe vlerësohen rregullisht arritjet e nxënësve, mblidhen tregues për aktivitetet e tyre, motivimi për shprehje artistike, angazhimi i nxënësve, përkushtimi në punë, bashkëpunimi me të tjerët dhe aktivitetet e tyre shprehëse, etj. (vlerësim formativ). Gjatë ndjekjes të arritjeve të nxënësve, mësuesi duhet të bëjë kujdes me qasjen individuale kundrejt çdo nxënësi.

Nxënësi vlerësohet me notë.

6 KUSHTE E AMBIENTIT PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT MËSIMOR

Programi në lidhje me kushtet e ambienteve bazohet në Normativën për ambient, pajisje dhe mjete mësimore për shkollën fillore nëntëvjeçare, të miratuar nga ministri i arsimit dhe shkencës me Vendim nr. 07-1830/1 të datës 28.02.2008.

7 NORMATIVA PËR KUADROT MËSIMDHËNËS

- Lëndën *projekte nga arti muzikor* mund ta jap mësues që ka mbaruar fakultetin e artit muzikor – grupi për teori muzikore dhe pedagogji.
- Nëse në konkurs nuk paraqitet kandidat që ka mbaruar degën e mësipërme, këtë lëndë mund jap mësues që ka mbaruar fakultetin e artit muzikor – grupe të tjera me kualifikim shtesë pedagogjik-metodik.

8 REZULTATET E PRITURA

Nxënësi / nxënësja:

- i di fazat e hartimit të një projekti nga arti muzikor (planifikimin i aktiviteteve dhe të kuadrit kohor, role, faza në realizimin, prezantimin dhe vlerësimin e rezultatit);
- merr pjesë aktive në të gjitha fazat e realizimit të projektit (aftësi planifikimi, aftësi hulumtimi, aftësi për marrjen e vendimeve adekuate, ndjenjë për kohën dhe afatet e fundit, aftësi komunikuese, aftësi organizimi, aftësi për mbajtjen e evidencës – portofolio, aftësi prezantuese);

- di t'i prezantoj të dhënat e nxjerra nga hartimi i projektit (për një temë të caktuar);
- mund të përdor kompjuter në lëndën e artit plastik.

9 KOMISIONI PËR PËRGATITJEN E PROGRAMIT MËSIMOR

1. Ankica Vitanova, këshilltar për edukim muzikor dhe artit muzikor në BZHA - Shkup
2. M-r Viktorija Kolarovska –Gmirja, profesioni jashtëm në fakultetin e artit muzikor –Shkup
3. Vladimir Janevski, profesor – DMBUC “Ilija Nikolovski-Luj” – Shkup
4. Florim Zylfiu, mësues – SHF “Diturija” – f. Likovë

10 VENDIM DHE DATA E MIRATIMIT TË PROGRAMIT MËSIMOR

Programin mësimor *projekte nga arti muzikor* për klasën e gjashtë të arsimit fillor tetëvjeçar, përkatësisht për klasën e shtatë, tetë ose të nëntë të arsimit fillor nëntëvjeçar e solli

Ministri

data _____